

07/ZDP/VE/2024  
Datë: 28 mars 2024

Në mbështetje të nenit 14.1, 15.1 (d) dhe (f), 69 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhëse të agjencive të pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 30, dt 05 shtator 2022), nenit 24 Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 7, dt 01 mars 2019) dhe në pajtim me Rregulloren Nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, siç është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (AAC) 05/2019,

Duke marrë në konsideratë Vendimet me nr. 08/ZDP/VE/2019 dt. 31.05.2019, 24/ZDP/VE/2019 dt. 31.07.2019, 26/ZDP/VE/2019 dt. 30 shtator 2019, 03/ZDP/VE/2020 dt. 30.03.2020, 09/ZDP/VE/2020 dt. 29.09.2020, 05/ZDP/VE/2021 dt. 30 mars 2021, 04/ZDP/VE/2022 dt. 30 mars 2022, 03/ZDP/VE/2023 dt. 30.03.2023 për vazhdim të përkohshëm të aprovimit të operatorit të ANP "Adem Jashari"- LKIA sh.a., si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

## V E N D I M

- VAZHDOHET** deri më **31 mars 2025**, aprovimi i Operatorit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" – LKIA sh.a. si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", për kategoritë 1, 2, 3, 4, 5, 6 (përfshirë pastrimin e jashtëm), 9 dhe 10, të shtojcës 1 të Rregullores Nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në tokë, të ndryshuar.
- OBLIGOHET** subjekti nga pika 1 e këtij Vendimi që gjatë kohës së ofrimit të shërbimeve t'iu përmbahet me përpikëri dispozitave të Rregullores nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, të ndryshuar dhe kërkesave tjera legjislative të sigurisë në fuqi për ofruesit e shërbimeve në tokë për palë të treta.
- Vendimi hyn në fuqi nga data 01 prill 2024.

## ARSYETIM

Më datën 16 prill 2019, operatori i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" – LKIA sh.a., ka aplikuar pranë Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vazhdim të aprovimit si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", për kategoritë 1, 2, 3, 4, 5, 6 (përfshirë pastrimin e jashtëm), 9 dhe 10 të shtojcës 1 të Rregullores Nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në tokë, me ndryshime.

Nga data e aplikimit deri më tani janë lëshuar për operatorin LKIA sh.a., aprovimet për zgjatje të përkohshme përmes vendimeve si në vijim: Vendimi nr. 08/ZDP/VE/2019 dt. 31 maj 2019, Vendimi nr. 24/ZDP/VE/2019 dt. 31 korrik 2019, Vendimi nr. 26/ZDP/VE/2019 dt. 30 shtator 2019, Vendimi

03/ZDP/VE/2020 dt. 30 mars 2020, Vendimi 09/ZDP/VE/2020 dt. 29 shtator 2020, Vendimi 05/ZDP/VE/2021 dt. 30 mars 2021, Vendimi 04/ZDP/VE/2022 dt. 30 mars 2022 dhe Vendimi 03/ZDP/VE/2023 dt. 30.03.2023. Vendimet e lartpërmendura për zgjatje të përkohshme të aprovimit për LKIA sh.a. janë lëshuar me qëllim që organi menaxhues i aeroportit të krijoj kushtet për hapje të tregut në përputhje me kërkesat rregullatore të parapara në Rregulloren 04/2011, të ndryshuar. Gjatë periudhës së vazhdimit të aprovimeve, nga organi menaxhues i ANP “Adem Jashari” është kërkuar krijimi i listës së infrastrukturës së centralizuar për shërbimet në tokë dhe çmimoret përkatëse, si parakushte për krijim e rrethanave për hapjen e tregut për shërbime në tokë për palë të treta.

Më dt. dt. 27 mars 2024, Drejtori i Përgjithshëm ka pranuar konfirmimin nga Departamenti i Aerodromeve dhe Departamenti i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit, që operatori është subjekt i mbikëqyrjes së rregullt nga departamenti i aerodromeve, bazuar në planin vjetor të mbikëqyrjes së sigurisë (annual safety oversight plan) dhe se rrjedhimisht, subjekti në fjalë vazhdon të operojë në përputhje me kërkesat legislative të sigurisë si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta; dhe respektivisht konfirmimin nga DBNRREA që operatori ka vazhduar të mirëmbajë kriteret ekonomike në bazë të cilave është aprovuar nga AAC si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në ANP “Adem Jashari”.

Vazhdimi i kohëzgjatjes edhe për një (1) vit bëhet me qëllim të interesit publik të ofrimit të shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, për kategoritë 1, 2, 3, 4, 5, 6 (përfshirë pastrimin e jashtëm), 9 dhe 10 (të shtojcës 1 të Rregullores) dhe krijim të kushteve për zbatim të normave rregullative në fuqi.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 14.1, 15.1 (d) dhe (f), 69 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, me ndryshime, si dhe nenin 24 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me Rregulloren nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, siç është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (AAC), 05/2019, dhe Vendimeve paraprake për vazhdim të përkohshëm të aprovimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të ngrit konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

  
**Burim Dinarama**  
UD. Drejtor i Përgjithshëm



Iu dërgohet:

- Organit menaxhues të ANP “Adem Jashari” LKIA, Vrellë, Komuna e Lipjanit;
- Komitetit për Partneritet Publiko Privat;
- Departamentit për Aerodrome;
- Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit;
- Arkivit të AAC-së.